



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 193/2010

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP), në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Sali Toplica dhe Muhamet Rexha, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Sladan Mladenovic në cilësinë e bartësit të listës të Inicativës Qytetare "Zavicaj" nga komuna e Parteshit, që ka të bëjë me parregullsitë gjatë procesit të votimit, në seancën e mbajtur më 25.08.2010, mori këtë:

### V E N D I M

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

### A R S Y E T I M I

Z. Sladan Mladenovic në cilësinë e bartësit të listës së Inicativës Qytetare "Zavicaj" nga Parteshi, ka parashtruar ankesë më datë 21.06.2010, me të cilën pretendon se në ditën e zgjedhjeve më datë 20.06.2010 në VV 3603D/01R dhe 3603D/02R, ka ardhur deri tek shkelja e rregullave të votimit nga ana e kryesuesit të KVV-së sepse sipas parashtruesit të ankesës, kryesuesi i KVV-së u thoshte votuesve që në LPV tek vendi ku ishte paraparë të jetë nënshkrimi të japin shenjat e gishtit tregues. Kjo gjë nuk është ligjore dhe nuk është paraparë me ligjin për zgjedhjet.

### F A K T E T

Më 30 qershor 2010, KZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Sladan Mladenovic në cilësinë e bartësit të listës së Inicativës Qytetare "Zavicaj" nga Parteshi, parashtruesi i ankesës pretendon se gjatë procesit zgjedhor ka pasur parregullsi të ndryshme.

Si kryerës të supozuar parashtruesi i ankesës ka paraqitur kryesuesin e KVV-së, në VV 3603D/02D dhe 3603D/01R, Nenad Spasic dhe Boban Cvetkovic.

Parashtruesi i ankesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi lidhur me rastin.

Mirëpo, në Raportin e Policisë së Kosovës nr.#6667, të datës 09.08.2010, theksohet se në lidhje me këtë ankesë kanë kontaktuar me Nenad Spasic i cili ka deklaruar që diku rreth 50 persona kanë lënë shenja të gishtërinjëve në vend të nënshkrimeve. Deri te kjo ka ardhur pasi që personi i parë i cili ka ardhur të votoj ka qenë analfabet dhe ai (Nenad Spasic) së bashku me anëtarët e komisionit Sentic Sasa nga Budriga e Poshtme, Ceci nga Parteshi, një vajzë dhe dy djem nga Pasjani, kanë marrë vendim

që në vend të nënshkrimit të merren shenjat e gishtit të votuesit, ku asnjëri nga komisioni nuk kanë qenë kundër. Personat të cilët kanë lënë shenjat e gishtit kanë qenë persona të moshuar dhe analfabet, dhe këto vota i kanë numëruar si të vlefshme.

Policia është munduar të kontaktoj me Boban Cvetkovic, por sipas babait të tij Zivko Svretkovic ai kishte shkuar në Zvicër.

Lidhur me këtë ankesë policia ka kontaktuar edhe me Prokurorin Publik, Z. Xhymshiti Xhyshiti dhe i njëjti ka thënë se këtu nuk ka elemente penale kundër Lirisë dhe të Drejtave të Njeriut nga (nenet 176,177,178,179,180 dhe 181) dhe ka sugjeruar që ta mbyllin këtë ankesë me një raport të veçantë dhe ta informojnë Prokurorinë Komunale Publike –Gjilan.

### ANALIZË

Juridiksioni i KZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

KZAP-i në pajtim me nenin 4.3 të Rregullores së Punës të Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia i dha mundësi Z. Nenad Spasic më 02 korrik 2010 të përgjigjej në ankesë dhe të jepte shpjegimet e tij për ngjarjen, gjë që nuk e ka bërë.

Ligji Për Zgjedhjet e Përgjithshme LZP (Ligji nr 03/L- 073) neni 118.1, parasheh si vijon:

*KZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, neni 3.6, pika (c) parasheh si vijon:

*3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit*

KZAP-i konstaton se Ankesa është e pabazuar sepse ajo është në kundërshtim me raportin policor nr.#6667, të datës 09.08.2010, dhe se parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur dëshmi bindëse.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

A nr. 193/2009 më datën 25.08.2010.

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**



*Muharrem Shala*